

Tradita : Festa e Verës në funksion edhe të Turizmit Vendor !

## “Kartolina” urimi dhe mesazhe paqeje nga Pogradeci për festat e fundvitit



**PËRSE PO LARGOHEN MOKRARËT?**

**QËNDRESA E FISIT BALLIU NË SLATINË E SENISHT**  
 Nga Zenun FERRO

**PORTRET I TRAKTORISTIT LLAZAR ILIA**

**UDHA E SHTËPISË**  
 Nga Bujar BALLIU

**LOTË PREJ BURRI**  
 Poezi nga Leoreta XHAFFERI

**KUMBIMI I LARGET**  
 Istref HAXHILLARI



Redaksia e Gazetës “Mokra” në takimin vjetor me rastin e Vitit të Ri!



**GJENERALBRIGADE DHORI SPIROLLARI MBRON TITULLIN “DOKTOR I SHKENCAVE”**

### Kur populli zgjedh njeriun e duhur

Nga Lavdërim MIMINLLARI \*

### NGUSHËLLIM

Redaksia e gazetës “Mokra” dhe kryesia e shoqatës “Pelioni” ngushëllon nga zemra z. Pëllumb Zade për humbjen e bashkëshortes së tij të dashur!



## HOMAZH LAMTUMIRE PËR SANIE ZADEN

Më 6 dhjetor 2011 u nda nga jeta, pas një sëmundjeje të gjatë Sanie Zade, bashkëshortja e kryetarit të shoqatës "Pelioni", Pëllumb Zade. Në lamtumirën e saj morën pjesë shumë miq, bashkëshatarë, të afërm, të cilët e përcollën me hidhërim të madh e me nderime për në banesën e fundit. Sania u lind në Çezmë të Madhe më 30 dhjetor 1945. Që prej afër një gjysmëshekulli ajo ishte bashkëshortja e Pëllumb Zades, me të cilin u martua në fillim të viteve 60-të, duke qenë përherë një mbështetëse e vazhdueshme e tij, si në jetën vështirë në Malinë, gjatë kohës së komunizmit, por edhe pas viteve 90-të, në proceset e demokracisë. Prej vitit 1997 ata u shpërngulën familjarisht në Tiranë, duke qenë përherë me zemër e me shpirt në Mokër, tek

njerëzit e saj të dashur, tek të cilët shkonte vazhdimisht, madje edhe në vitet e muajt e fundit të jetës, edhe pse ishte e sëmurë.

Sania la pas një emër të nderuar, që do të kujtohet nga familjarët e saj, nga njerëzit e saj të shtrenjtë që humbën këtë njeri të dashur që do t'u mungojë përgjithmonë.

Redaksia e gazetës "Mokra", kryesia e shoqatës "Pelioni", shprehin ngushëllimet e sinqerta z. Pëllumb Zade për humbjen e njeriut të tij të dashur. Qoftë përherë i paharruar emri i saj!

HAKI BALLIU, ZENUN FERRO, SAMI LEKA, ZABIT ÇUKU, FLORI SLATINA, ARIZ DURBAKU, ISTREF HAXHILLARI, BUJAR BALLIU, LLAZI TONA

Tradita : Festa e Verës në funksion edhe të Turizmit Vendor !

# "Kartolina" nga Pogradeci për festat për gjithë shqiptarët kudo të ndodhur

Nga Koço Pihoni

Pogradeci në datat 16 - 17 dhjetor festoi, me pjesëmarrjen e mijëra qytetarët, vertarët e vreshtëtarëve, si dhe të ardhurit e shumë nga qytetet të tjera të vendit, festën tashmë sa tradicionale, aq edhe popullore, festën e verës, një nga shyllat e përmirësimit e të zhvillimit e turizmit vendor i cili tashmë përbën një përparësi të një turizmi elitare të vendit.

Festa e zhvillua në një atmosferë të ndezur me shumë dekore, bujtina të drunjtë, të cilat shërbenin dhe si qebapto-re nga verëshitsa e shumë të vendosura në dy anët e Bulevardit "Njëqind hapa larg Evropës". Atje ish ngritur dhe podiumi në të cilën deputuan shumë grupe artistike nga rrethi e qarku i Korçës. Të pranishëm në këto festime kishin ardhur enkas për të marrë pjesë Kryetari i Shtetit zoti Bamir Topi si dhe Ambasadori të akredituar në R. Shqipërisë me bashkëshortet Ambasadori i Hollandës dhe ai i Izraelit dhe shumë miq e të ftuar nga bota e Biznesit e Artit etj.

Kjo pjesëmarrje dëshmon njëherazi dhe për vlerësimin e kësaj feste qytetare me individualitet dhe mesazhe kulturore, bashkimi, njohje e bashkëpunimi. Në pritjen tashmë tradicionale të organizuar në Bashkinë e Qytetit nga Kryetari i Bashkisë zoti Artan Shkëmbi ndër mysafirët specialë padyshim bënte pjesë e zoti Bamir Topi të cilit iu rezervua të bënte simbolikisht edhe "Hapjen e Kanellës së Butit" dhe të Uronte nga kjo Bashki, Gjithë shqiptarët të ku do ndodhur për festat e fund vitit e një Vit të Ri të mbarë me shëndet dhe realizime të dëshirave në familjet e tyre, duke u bërë kjo festë dhe

"Kartolona" e parë për urimet e festimeve të Krishlindjes e Vitit të Ri.

Në këtë natën e parë e njohur tashmë, Nata Poetike e cila u zhvillua në ambientet e Bar -Restorant Turizmit Enkelanës. Atje të pranishmit kryesisht të ftuar mbushën sallën e këtij mjedisi e më pas nën drejtimin e Poetit Dhimitër Pojanaku e stafit të asaj jurie ish precizuar edhe organizimi i kombinuar i dhënies e marrjes se fjalës nga drejtuesit e lartë të pranishëm në këtë fes-



tim shumë miqësor e shumë të kulturuar i cili në gjithë kohën mbushej nga kënga e magjishme nga trupa e ansambllit Nostalgjia.

Në dekorin e këtij mjedisi citohen vargjet e poetit Pojanaku : "I Rëfehëm Verës, si pylli Mjegullës!" Natën poetike e deklaroi të hapur zoti Pojanaku duke Uruar me gotë të mbushur me Verë, zotin Shkëmbi si iniciuesin e organizatorin kryesor të kësaj Feste tashme prej gati 10 vitesh nga më të këndshme e

promovuese për vlerat e gjithçkaje të arritur në turizmin gjithë vjetor në këtë qytet. Më pas fjalën e mori zoti Bamir i cili përshëndeti të pranishmit e gjithë shqiptarët kudo të ndodhur në mbarë vendin e botë duke u shprehur se : Pafat fat që mu dha fjala në fillim se më pas nuk dihet se si do shkojë kjo festë me pije " në fjalën e tij, zoti Artan Shkëmbi falënderoj së pari miqtë e nderuar Presidentin e Ambasadorët e bashkëshortet e tyre e gjithë të pranishmit

në atë auditor dhe "Urdhëroj" poetin Pojanaku në detyrën e drejtuesit të këtij evenimenti festiv që të bëhen më pak fjalë e të mbushen e pihen me shumë gota me plot. Natën poetike e përshëndeti dhe Ambasadori Hollandes jo me fjalë, por duke luajtur në pjano disa pjesë nga repertori i këngëve Hollandeze. në pas në fjalën e marë nga Piktori i Merituar Pogradecari Anastas Kostandini i cili në fjalën e tija falenderoi Ambasadorin Hollandes dhe tregoj se ishte befarsuar nga pjesëmarrja në një Ekspozitë e arteve pamorë të vizituar në Amsterdam kishin qenë plot 35 piktura me peisazhe nga Pogradeci të ekspozuara!

Ngela i mrekulluar e krenar për vendin tim. Kostandini ju dhuroj të pranishmëve Një Cikël me punime kushtuar ditës së festës së verës Pogradec TASO. Në këtë festim u promovua dhe botimi shumë shkencor me autor Ing Agronom Naum Pasko "Kultivimi i Rusht e pregatitja e Verës në familje "

Mbremja festive vazhdoi me këngë për verën të kënduara nga këngëtarët Ermira Babaliu Verë Shitësi. Nesti Macolli, Ylli Cela e grupi Nostalgjia do citoj vargjet Shtjerna more çunçe shtjerna, shtjerna o raki të pimë. Me atë ibrik të Argjëndë, çunçe seç na more mëntë. Më pas komisioni i kësaj Nate Poetike vlerësoj krijimet më të mira dhe shpalli Fituesit. Me çmim të parë u vlerësua krijimtaria e poetit Eduard Sulollari. Me çmim të dytë poetesha Roza Krëste.

### Solidarizim i degës së shoqatës "Pelioni" të Kombinatit

Ne, dega e Shoqates "PELION", ne Kombinat, Tirane u njohem, nepermjet gazetes "MOKRA", në numerin e saj te fundit me ftesen e Kryeredaktorit Flori Slatina dhe qe ne fillim theksojme: Jo vetem qe jemi dakort me ftesen, por do te kontribuojme sadopak qe gazeta jone , te behet e dashur dhe e mirepritur per te gjithë mokraret.

Gazeta jone ne keto vite eshte rritur e berruar, tani ajo eshte ne moshen e pjekurise, ku me shkrimet e saj ajo jo vetem pasqyron realitetin ne Mokren tone, por edhe ne te "larguarit" na shumefishon krenarine e te qenit Mokrare.

Ne kete kuder, pa permendur emera, ne shoqata "PELIONI" e Kombinatit falenderojme me gjithë zemer te gjithë stafin drejtues te Shoqates e ne te njejtën kohe te gjithë ata qe me shkrimet e tyre ne gazeta na e kane sjelle me afer krahinen tone e vecanerisht kryeredaktorin e sa z. Flori Slatina .

FALEMINDERIT.  
KRYETARI  
BUJAR QYRKU

SEKRETARI  
HARIS DURBAKU

## AKTIVITETE KULTURORE NË 115-VJETORIN E LINDJES SË LIRIKUT TË MADH, LASGUSH PORADECI

Në nderim të lirikut të madh, poetit Lasgush Poradeci, në 115 vjetorin e tij të lindjes, drejtorja Arsimore në Pogradec organizoi të shtunën një veprimtari kulturore, ku u përkujtua jeta dhe vepra e poetit. Pedagogë, studjues dhe poetë, folën për krijimtarinë e Lasgushit, simbolikën e poezisë, veçorinë e ligjëritimit të tij poetik, botën Lasgushiane dhe letërkëmbimin e poetit me mikun dhe prozatorin e shquar, Mitrush Kuteli. Pas dokumentarit për Lasgushin, të pranishmit ndoqën një koncert të fjalës artistike, me vjersha të përzgjedhura nga vepra e tij, kujtime nga bashkëkohës të poetit, si dhe një ekspozitë të piktorëve A. Kostandini, S. Lako e G. Zeka, me motive nga jeta dhe vepra e tij.

“Pse parapëlqej të shkruaj vargje dhe jo prozë?”, “Kur them vargje, kuptoj që duhet të jenë të përsosur nga arti. Vetëm këto të përsosurit rrojnë...” Për këtë poeti ka vetëm ditëlindje”, janë disa nga vargjet e poetit të madh.

Llazar Gusho, i njohur në letrat shqip me emrin letrar Lasgush Poradeci, ka lindur në Pogradec më 1896. Studimet e sh-



kollës së mesme ai i kreu në Manastir e Athinës, dhe më pas studjoi në Bukuresht në vitin 1921, e në Grac të Austrisë në vitin 1924. Familja e tij ka luajtur një rol të vaçantë në çeljen e Shkollës së Parë Shqipe në Pogradec, në vitin 1887, ku vetë Lasgushi ishte një ndër patriotët më në zë të lëvizjet patriotike të kolonisë shqiptare të Bukureshtit. Ndër vjershat e para të tij, janë “Dita e njëzet e tetës”, “Naimit”, “E fundit mërzi” etj. Në vitin 1933, u botua vëllimi i

tij poetik “Vallja e yjeve” dhe më 1937, përmbledhja e dytë “Ylli i zemrës”. Veç lëvrimin të poezisë, poeti shqipëroi, me një nivel të lartë artistik pjesë nga krijimtaria e poetëve botërorë si Eminesku, Mickievic etj. Vepra e tij, së bashku me letërkëmbimin me Dhimitër Paskon, është përmbledhur në katër vëllime. I fundmi i simbolistëve evropianë Lasgush Poradeci, vdiq më 1987 dhe sot Shtëpia e Kulturës së qytetit të tij të lindjes mban emrin e poetit të madh shqiptar.

## GJENERALBRIGADE DHORI SPIROLLARI MBRON TITULLIN “DOKTOR I SHKENCAVE”

“Menaxhimi, kontrolli dhe mbrojtja e hapësirës ajrore shqiptare në kushtet e integritimit në NATO dhe Bashkimi Europian”, më datën 13.12.2011, ishte tema e caktuar nga Departamenti Strategjisë dhe Historisë pranë Akademisë së Mbrojtjes “Sipro Moisiu”, për t’u mbrojtur nga disertanti gjeneral-brigade Dhori Spirollari, dhe me udhëheqës teme Prof. As. Dr. Agron Agolli. Tema u mbrojt në ambientet e Akademisë së Mbrojtjes “Sipro Moisiu”. Komisioni i vlerësimit të diserantit kryhesohej nga Profesor Dr. Pajtim Ribaj dhe përbëhej nga pesë profesorë. Për ta ndjekur nga afër prezantuesin merrnin pjesë dhe një numër i gjërë dëgjuesish civilë e oficerë të gradave dhe funksioneve të ndryshme. Për të realizuar me sukses diseracionin e tij, autori ju përgjigj me kompetencë dhe me qartësi tre pyetjeve kryesore nëpërmjet tre përgjigjeve; Cila është gjëndja aktuale mbi kontrollin dhe Menaxhimin e Hapsirës Ajrore Shqiptare? Cili është roli dhe prespektiva e bashkëpunimit civil ushtarak në përdorimin e hapësirës ajrore? Si dhe dhënien e një modeli sa më efikas të vëzhgimit dhe të mbrojtjes Ajrore për kushtet e vendit tonë. Për të folur për gjendjen e kontrollin të hapësirës ajrore nëpërmjet aviacionit diserantit e filloi me një histori të shkurtër të zhvillimit të mjeteve ajrore. Ai u ndal që nga përpjekjet e para të njerëzimit për përdorimin e hapësirës ajrore. Nga shpikja e mjeteve të para të fluturimit ajror, përdorimin e tij si mjet lufte, për vrojtim dhe bombardim, deri tek fitorja e fushatave ushtarake vetem me aviacion sikurse ndodhi gjatë ndërhyrjes së forcave ushtarake amerikane në Kosovë. Më pas ai ngriti op-



sionet dhe bëri një analizë të detajuar për rolin dhe prespektivën e bashkëpunimit civil ushtarak në përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës ajrore. Vendin më të rëndësishëm në punimin e tij e zuri pjesa e tretë mbi “dhënien e një modeli sa më efikas të vëzhgimit dhe të mbrojtjes Ajrore për kushtet e vendit tonë”. Komisioni i vlerësimit, pasi dëgjoj me vëmendje prezantimin e bërë nga kandidati për doktorant gjeneral-brigade Dhori Spirollari, dha vlersimet individuale, nga çdo antar dhe më pas atë unanim që padyshim i dha vlersimin maksimal të mundshëm. I rëndësishëm

është fakti se ky studim, u vlerësua sa shkencor aq edhe aktual dhe një projekt plotësisht i aplikueshëm dhe eficient për kushtet e vendit tonë. Ndaj dhe të pranishmit në këtë prezantim krahas suksesëve që i uruan diserantit dhe vlersimeve për punën e kujdesshme që kishte bërë, uruan që ky studim-projekt të gjejë aplikim sa më shpejt në funksion të menaxhimit, kontrollit dhe mbrojtjes sa më mirë të hapësirës ajrore shqiptare në kushtet e integritimit në NATO dhe Bashkimin Europian.

Nenkolonel Ksem SALIASI,  
Gazeta Ushtria 16 dhjetor 2011

## Kur populli zgjedh njeriun e duhur



Nga Lavdërim MIMINLLARI \*

Nuk e kisha vizituar komunën e Trebinjës që prej vitit 1993, ku ne territorin e kësaj komune ndodhej miniera e qymyrgurit të Potgozhanit. Vitet kalojnë dhe si çdo njeri që emigroj edhe unë, i dashur lexues, mu desh të emigroja edhe të kthehesha përsëri për të kuptuar se vendi tend është me i shtrenjti ne bote. Ka qene koha kur ne komunën e Trebinjes ish-kryetari shkarkohet per nje problem korrupsioni, per te cilën u pushua nga detyra dhe “Koalicioni për qytetarin” vendosi te kandidoje ne këtë komune 6 muaj para zgjedhjeve të 2011, zotin Feim Jasharlari, përfaqësuesi i LSI-së. Kur kandidatura doli para popullit te kësaj komune disa e priten mire e disa me mendime te ndryshme. Ndërkohë nga “Koalicioni për të Ardhmen” u vendos një doktor i po kesaj zone por qe punonte ne nje komune tjetër. Gara ishte mjaft e vështire por binte ne sy jeta dhe respekti ndaj Feimit qe ishte i lidhur ngushte me mokraret jo vetëm kur takoheshin ne fshat por edhe kur rastësisht i piqnin rrugët e Pogradecit. Kjo është nje nga arsyet qe i dhane fitoren Feimit. Kandidimi i dyte u be ne zgjedhjet e 8-majit 2011 ku “Kualicioni per Qytetarin” u prezantua përsëri me zotin Feim Jasharlari por kësaj radhe Feimi kishte ç’tu thoshte, se per 6 muaj beri ate pune qe te tjeret per 2-3 legjislatura nuk e kishin realizuar dot. Dikush do pyesi se çfare bëri? Më lejoni t’ua them: të gjitha rrugët e fshatrave te kësaj komune u ndriçuan dhe sot të jep përshtypjen naten sikur po shikon nje grup qytetesh te vogla. Për te vazhduar me shkollat te cilat ishin ne gjendje te mjerueshme. Disa rruge te paakomoduara jane kthyer ne gjendje te mire për te plotësuar dhe per te lehtësuar nevojat e banoreve. Rasti i freskët përta i përket kësaj me lart eshte rruga e Dunices, e cila është shndërruar tashme në një rruge bashkëkohore, ndersa Koalicioni per të ardhmen vuri nje kandidat te po kesaj zone, por ne krahasim me të parin ishte me i dobët. Këtë e tregoi edhe rezultati votimeve. Dikush mund të shprehet se Mokra ka qene gjithmone e majte, por kesaj here tregoi se nuk ka rëndësi bindja por njeriu i duhur ose

njeriu që të “qan hallet”. Por te mos harrohet se kjo u shfaq më së miri në Festen e Kurban Bajramit që ky djalë i ndau 500 familjeve të varfëra nga 5 kg mish duke qëndruar vete në këmbë pa pyetur se kush është i majte apo i djathte, por kush ishte në nevojë. E gjitha kjo u mundësua nga vete kryetari dhe një biznesmen nga Lushnja i cili dha ndihmën e tij për te respektuar festen e Kurban Bajramit dhe për te ndihmuar banoret. Kjo i dedikohet kryetarit qe përfaqëson siglën e LSI-se. Unë mendoj qe ky humanizëm të mbizoterojë ne te gjitha komunat, pavarësisht se kush force politike drejton, jo si ne një komune tjetër që drejton Koalicioni për te Ardhmen, qe ne te vërtet u shpërndanë 5 kg mish, por qe për fat te keq mbizotëroi diferencimi ne bindje politike dhe per me teper mishi u sponsorizua nga një shoqate islamike dhe nuk duhej qe komuna te shfrytëzonte këtë rast për interesat e veta por ne te kundërtën duhej qe te ishte respektuar festa e Kurban Bajramit, siç ishte edhe dëshira e shoqatës islamike.

Edhe me rastin e Vitiit të Ri janë shpërndarë pako për 805 fëmijëve në shkolla e kopshte. Ndërsa u ndanë pako edhe për 322 familja të varfra në këtë komunë. Prandaj duke iu referuar edhe zhvillimeve te fundit te politikës do te doja te vija ne dukje qe politika te zgjedhë njerëzit e duhur qe i mbështet dhe mbështetin popullin e jo si ne disa raste qe hasem ne kete fushate ku kandiduan për te dytën here te njëjtët persona dhe dështuan. Eshte per te theksuar dhe nuk me vjen mire kur disa ish-pushtetarë kundërshtojnë vendimet e drejtësisë se ne rastin e Dritan Priftit i cili tregon se ai është nga jugu a nga veriu qe ne te kundërtën fut ne armiqësi e jo tregon drejtësi. Kësaj thenie duhet t’i gjejmë vendin dhe drejtësia te japë e verdiktin e saj. Mendoj qe si ne komunën e Trebinjes ka nevojë qe shteti te hedhe sytë edhe ne rrugën qe lidh kete komune me qytetin, qe ka mbetur mbrapa për disa mbushje me çakull por qe ne te njëjten kohe te kushton sa per te shkuar deri ne Tirane. Këtë e vuanjë banoret e kësaj komune, mësuesit edhe doktorët qe shërbejnë ne kete komunitet. Shpresojmë qe qeveria te hedhe sytë nga ne dhe te ndihmohet kryetari ynë.

\* Vazhdon studimet e larta për turizëm, biznes në Universitetin “Fan Noli” në Korçë. Ka mbaruar shkollën teknik miniere dhe më pas ka kryer disa specializime, ku më i rëndësishmi është ai për kontrollin e ushqimeve dhe turizëm në SHBA. Zotëron anglishten shumë mirë, pasi ka jetuar për mëse 12 vjet në SHBA. Është një sindikalist i shquar që prej vitit 1991, ku bën pjesë.

# Lotë prej burri

Poezi nga Leoreta XHAFERI

## Kjo jam unë

Si ç' do qenie humane unë jam një njeri, fallso s' mund të shtirem nëpër fatkeqësi, nuk bëj jetë mondane, as nuk mbaj stoli, as ombrellë nuk hap kur ec nëpër shi.

Në gëzime e dasma di mirë të këndoj, dhe kur hidhërohem fare lehtë vajtoj, e varfër, e pasur mendjen nuk e vras, një peng që më mundon dua ta lë pas.

Shikoj veç përpara, kokën pas s' e kthej, forcën për të jetuar me çdo kusht e gjej, e bukur, e shëmtuar unë jam kjo që jam mbaj veç një fytyrë, maskë të dytë nuk kam.

## Dhe vjen një ditë

Dhe vjen një ditë, braktisjen nuk e sheh pranë teje, ke dikë që të tregon se kush je netëve ëndrra të bardha ti ke.

Dhe vjen një ditë, kur ti sheh veten të dashuruar, më këngën në buzë nis ëndërron, për herë të parë sheh se ekziston.

Dhe vjen një ditë, buzëqeshja sërish të kthehet, trishtimin, vetminë ti braktis lumturinë kërkon, një jetë të re nis .

## Ne dhe vjeshta

Vjeshta, perëndia e gjetheve, trishtimin mbjell në tokën e lagur nga lotët e diellit. Prej dëshpërimit kthyer në shi, mbi mbulesa të arta gjethesh shkelim, pranverë presim.

Me shpresë zgjatim duart tona largësia tretet, shpirtërat puthen netëve.

## Dashuria e hënës

Hëna kreh flokët e verdha, në qerpikët e zi të një vajze lutet të puthë fshehur dashurinë e saj, agun tundues natës asgjë nuk i tregon, heshtur pret agimin e bardhë.

## Magji poezie

Ju njerëz që pas ekrane kompjuterash iu njoha, nga vargjet lexuar iu shoh as vetë nuk di se si, veç ca fjalë poezie kemi thënë mes njëri-tjetrit, por di shumë mire që jeni poetë, e sot miqt' e mi.

Si të tillë një të fshehtë time tani po iu them, nuk mund të fshihem dot, kam rënë në dashuri, Mos u trembni, nuk po dashuroj poet apo njeri, por dua veç atë, hyjnoren, të magjishmen POEZI!



## Lotë prej burri

Kështu qan një burrë kur i thyhet zemra, nuk i shkon për mend se rrotull ka femra! Nuk i mban dot lotët, shembet në fytyrë, kur bëhet viktimë në këtë botë të ndyrë.

Vajtojnë edhe burrat s' është ndonjë çudi, lotojnë kur largohen nga grua dhe fëmijë. Kur shkon dashuria edhe më nuk vjen nuk pyet për askënd, veten nuk e gjen.

As vetminë gangrenë një burrë s' e duron, vdekja si shigjetë zemrën krejt i'a shpon. Në fundin e shpirtit rezervë ca lot mban sa here i dhemb shpirti nis , e qan, e qan!!

## Mjaft me trishtim

Fytyra tëqeshura dua të shoh, zëra fëmijësh parqeve lodruar, valse lumturie, tinguj kitarash prej telash që nuk njohin ndryshk. Vajza me bukuri hyjnore, djem të hipnotizuar prej dashurisë, aroma lulësh, fllad pranveror zogj që fluturojnë të lirë kaltërsive qiellore. Kaq më duhet për të jetuar, nuk kërkoj asgjë më shumë harmoni, pak qetësi e gëzim, nuk dua më dhimbje e lot, mjaft më me trishtim.

## Më premo

Sytë e tu, labirinte ku shpirti im humbet. Heshtur ndaloj atje, një moment, tundothem. Ëndërroj të bëhem i vetmi notar ne atë det. Dashurinë si kristali ta rrëmbej e të largohem. Më pas ti të rendësh pas gjurmëve të mia netëve ku ëndrrat i thur, ditëve që për ty janë mendim. Veç ti rrëmbema shpirtin, sytë tanë dehur nga dashuria shkrirë në të njëjtin oqean lidhin aty, një premtim, një besë që mos ta shkelim, as unë, as ti, as vdekja. Me petkun e magjisë ta mbrojë vete perëndia. Më duaj aq, sa dot me fjalë mos ta thuash. Mos i ler djajt' e ferrit te shkelin premtimin se me do. Grabite fshehtëzi zemrë time mos rresht kurrë të më duash, më ler ta kem veç unë kristalin tënd të dashurisë, puthjen e syve tanë të harruar të lutem më premo.

Tregim nga Istref HAXHILLARI

# Kumbimi i largët

Burri i panjohur u duk në mes të marsit. Ndonëse pati hyrë pranvera, dëborë ende zbardhte lartësive. Relievi i rrëpirët pritej aty-këtu nga përrenj të vegjël malorë. Tutje grumbullit të kodrave ngjyrë gri, horizonti mbyllej prej majave kaltëruar me mbeturina resh. I huaji qëndroi përpara shtëpisë së re të Kadiasve duke zhbiruar derën, gdhendur në druarrë. Relievi përdizej nga drita e zbehtë e pasdites.

Kanati kërciti me zhurmë të mbytur dhe një grua shtatlartë, pak e kërrusur, hapi derën, vështroi me frikë nga brendësia. Flokët tërësisht gri, lëkura ngjyrë dheu, spërkatur me guka të kafta sa një majë thoi, rrezatonin hirin e vonë prej reliktesh të çmuara.

-Urdhëroni! - Fjalët i dolën të trembura.

-Kam ardhur për ustallarët, - tha Teodori.

-Po, po, djali është në shtëpi, - nxitoi të përgjigjej.

Teksa i hidhte hera-herës sytë profilit të burrit që druhej ta vështronte drejtpërsëdrejti, Marina se si u ndje, mezi mbushej me frymë. As e kuptonte përse, ai dukej aq i urtë, shpirt njeriu, po zëri, ajo kërcitje e portës e tronditën. I kaloi në mendje kujtimi i vjetër:

"Degët e zhveshura të pemëve dhe, në njëjtën kohë, kumbimi i largët i portës si rënkim i ulët, i zvargur."

Përjetimet e vjetra qenë fshirë pa lënë gjurmë, po ky pluskonte nëpër kohë, zhdukej dhe shfaqej sërish. Nuk pati mundur të ruajë asnjë suvenir a ëndërr, përveç këtij përfytyrimi që iu fanit tani më i qartë e i kthjellët se disa gjëra të ndodhura dje.

Nata e dikurshme u derdh e freskët dhe e frikshme me të gjitha hollësitë: një degëz nis të lodrojtë pas dritares, ndërsa tingulli i shpifur kumbon në portë...

Në sytë e butë kadife të nuses së re, qerpikët e gjatë linin pjesërisht të pasqyroshin rrezet e dritës. Të shoqit i pëlqenin ashtu të thellë pa shkëlqim.

"Janë aq të ëmbël, sikur përkëdhelen", - i tha mbrëmjes kur u largua. Marina buzëqeshi me hidhërim; nga ajo ditë kaluan dy vjet. E kujtonte herë pas here, po nuk i bëhej të vinte, ishte punësuar në një shoqëri detare. Kështu shkruante në letrat e rralla. Ajo mërziqej, shqetësohej.

Vuri djalin në gjumë, iu afrua dritares.

Në fund të vjeshtës fshati shpërhapte ndjenjë të thellë trishtimi. Netët bëheshin të freskëta e gri. Përmbi tokën, ndriçuar dobët nga hëna e çrregullt pa përmasa, era frynte e acartë. Nga kopshti i braktisur vinte aromë e athët kalbësire. Pemët tundnin gjymtyrët lakuriq nën veshjen e shpartalluar të gjetheve, vështroinin pa u lodhur në një pikë të vetme.

Papritmas frymëmarrja iu shkurtua, ndjeu rrjedhën e gjakut nëpër damarë. Nuk qe e thënë të shkiste si të tjerat ajo mbrëmje e vonë. S'arriti ta shpjerë deri në fund qerthullin e përnatshëm, puthja e të shoqit i ngriu buzëve: në portë u përvijua trokitja e lehtë, e trembur sikur lutej të mos hapej kurrë kanati i rëndë. Tingulli i mekur e goditi me shuplakë.

Ia nguli sytë errësirës.

Jashtë ndehej qetësi e verbër. Pemët e përgjumura, vaditur me dritën e lagësht të hënës, vazhdonin ta sodisnin paturpësisht. Në mënyrë instiktive, mbuloi gjoksin.

"Zot, më bënë veshët!" - belbëzoi e lehtësuar.

U rrek ta largonte mendjen, i bëri shenjë djalit të shkonte në shtrat. Një pjesë brenda saj shpresonte.

Trokitja u përsërit më e guximshme, largoi dyzimin dhe porta oshtiu me jehonë të çjerrë e të zgjatur. Çapiti zorshëm, trazuar nga parandjenja të zymta. Kuadratit gjysmë të hapur u duk një burrë zhelan me fytyrën fshehur nën kapele.

"Qenka lypës", - u qetësua.

Vetëm disa sekonda.

I panjohuri zgjati letrën e zhubrosur me pikla të vogla ngjyrë balte. Lëvizjet, të plogëta si paralitik.

Marina u rrëqeth.

-Ç'është? - ulëriu.

Ai heshti, si t'i kishte ikur goja në atë çast.

-Telegram, - mermëriti sa mezi u dëgjua.

Pas hutimi të parë shtoi me zë të përhimë:

-Yt shoq ra në det.

-Si, në det...? - Fjalët erdhën duke u shuar, në pamundësi t'i shpëtonin grackës së fytit që ngushtohej me shpejtësi. Pas shpine u afrua Teli shtatëvjeçar i trembur me sytë e skuqur, të lotuar.

Ankthi kërkëllinte.

-Zonjë, të rrojë djali! - I panjohuri shtriu dorën, nuk arriti t'ia jepte. Marina ra me zhurmë të thatë.

Ai u tremb, kapërceu pragun. E goditi lehtë, pastaj më fort. Merrte frymë me zor, dihaste.

-Ujë, sill ujë, - i tha djalit.

Marina rënkonte, a thua jepte shpirt. Shikoi të birin me sytë e hapur jashtë mase, u kujtua dhe bërtiti sa i hante zëri.

I huaji u largua me të shpejtë. Pas tij era mbuloi si fashë e ndotur plagësh lotët e saj, zhurmat e natës mbytnë dënesat...

I hodhi sytë mikut që bisedonte shpënguar me të birin. Tani iu duk ndryshe, mori frymë e shtendosur nga makthi.

"Ndoshta, - mendoi, - kështu vjen pleqëria, janë shenjat: të ikurit thërresin gjithnjë për diku dhe ti nuk u shpëton dot, bën marrëzira."

Teli e pati bërë zakon t'u fliste miqve për brengën e familjes. Ndihej mirë kur e ndante me të tjerët. Sa herë niste të tregonte, sigurohej të mos ishte aty e ëma.

Atmosfera e ngrohtë e bëri më të lehtë kërkesën e Teodorit.

-Lagjja jonë ndryshon nga të tjerat. Kisha mban emrin e shenjtores.

-E di, - tha Teli, - jeni më të lashtët.

Ai e shikoi me admirim.

-Vendosëm ta bëjmë të fisme si kisha. Kemi bërë ca para në emigracion.

I zoti i shtëpisë e shikoi në mënyrë pyetëse.

-Duam të ndërtojmë shtëpitë sipas modelit të Ohrit. Amanet i herëshëm, brengë si puna e asaj suajës.

Foli gjatë. Më se njëherë sytë iu mbushën me lot.

Paso! heshtje e shenjtë. Të dy bluatin fjalët e njëri-tjetrit. Ustai i gurit u zu ngushtë, por edhe u ndje krenar. Të krishterët sqimatarë mund të gjenin muratorë në vise të tjera.

-Do të bëjmë më të mirën, - premtoi Teli.

Kur Theodhori i zgjati dorën të përshëndetej, Marina u angështua përsëri, po e mbajti veten.

"Falë Zotit, djalit nga nuk e kërkojnë", - u gëzua. Ashtu me buzë në gaz iu drejtua të birit:

-Jam fajtores.

E përmendte shpesh, po këtë radhe dukej si shaka.

-Jo, - tha Teli, - aspak. Të brente meraku nëse do t'ia dilnim. Edhe unë kisha frikë, të them të drejtën.

-Mund ta kishit filluar më parë.

-Po...

Teli kujtoi dy vite më parë kur nisën përçapjen e vështirë. Në fakt brenga dhe nevoja e mësuan, i dhanë shtytën të mos largohej.

Në fillim u zemërua keq me të atin:

"Përse duhet të binte në det?"

S'i shqitej nga sytë pamja tronditëse, as figura e zhelanit të panjohur. Sa avitej mbrëmja gjithçka projektohej dhunshëm në kanatin e gdhendur të portës.

Vuajtjet e ndoqën në çdo hap.

Akoma fare i ri, rrudha të holla iu përvijuan tëmthave. I dukej sikur nuk pati qenë asnjëherë i vogël. Kur ndjeu se duhet të ndiqte gjurmët e të atit, hezitoi. Pas tij e shkuara ngurtësohej si ndëshkim i ashpër.

Ulur mbi gurin e madh përfund oborrit, treti vështrimin mbi peizazhin e thyer. Gjer tutje horizontit vendi mbulohej me shkrepë e rrëpira. Grijat e kudondodhur vriste sytë. Marina u afrua, i mori kokën në gj. Më parë Teli çlodhej e ndihej mirë, tani qe burrrëuar, qimet e brymta mbi buzën e sipërme e tregonin djalë të pjekur.

E largoi butësisht.

-A thua erdhi koha? - pyeti me zë të pakët, më shumë veten.

Marina u zu ngushtë. Askush nuk donte të largohej e prapë merrnin rrugët. Iknin, harronin të ktheheshin. Kujtimet e fundosura njomnin gjithçka vështronte rrotull vetes. Pranë të birit i rrezohehin nga supet brengat, hidhërimet.

Fjalët shërbenin vetëm sa për të thënë diçka.

Teli bluante të tjera mendime. Ndërsa hapësira e pamasë pasqyronte përhitjen e fortë të gurëve, në një qosh brenda vetes vegjetonte si mundësi fatlume grishja e tyre. Fshatit i patën munguar ustallarët.

Pajtonin të huaj. Këta qenë të rrallë.

-Do ta ngre skuadrën e muratorëve.

Marina ngurroi.

-Si mund të jesh kaq i sigurt? - e pyeti.

-Sepse as unë nuk e di.

-Është me rrezik.

-Do të nisim me kasollen, - u përgjigj. Tashmë e kishte marrë vendimin; në cepat e buzëve u përvijua buzëqeshja e lehtë ... Për t'i dhënë zemër.

Marina lëshoi pe. Sido që jo fort e bindur.

-Të ndihmoftë Zoti! - e beko.

Sytë i vezulluan nga lagështia.

Brigada e ndërtuesve zuri fill në të mbaruar të verës një ditë të plogësht, ngarkuar me ndryshkun e pemëve. Në moshën e Telit e më të rinj, djemtë nuk kishin përvojë. Po ambicie dhe dëshirë.

I kërkonin ngado.

Tani edhe i krishteri i qytetit...

Punuan tërë atë javë, të dielën u nisën. Rruga vinte e përpjetë, spërdredhur nëpër faqe kodrash të pjerrëta. Teli nxitonte.

"S'është si më parë, ka ndryshuar, - përkeqej me vete. - Ngaqë rri vetëm, Tixhja nuk mund të vejë shpesh, druhet."

Sido që koha e ashpër i shmangte ndjenjat e holla, zemra i gufonte. Në një kënd të mendimeve, zëri i brishtë dhe sytë e rimitë të Tixhes vegonin pa pushuar, flokët e shpupuritur ndritnin si lajthi të arrira.

Shiu i hollë e pengoi.

Marina priste e shqetësuar si përherë. Nuk e nxinte vendi, hapi dritaren. I dukej se po ta priste aty do të vinte më shpejt. Drita e muzgut ngarkuar me lagështirë sulmoi dhomën, praroi muret me bojë të argjenditë.

Vështroi imazhin e vetes, reflektuar në xham.

"Nuk jam plakë. Pa rrudha, lëkura e njollëzuar vërtet, po nuk është vyshkur e plasaritur." - Krahasonte veten me të moshuarat.

Pastaj frymëmarrja iu shpeshitua, po i merreshin këmbët.

Tixhja e zuri për krahu, mbylli dritaren.

-Është ftohtë, - i tha, - marsi anon nga dimri.

-Po, po, - u bind Marina.

Mbi divan e zuri gjumi. Mbështetur në njërin krah dukej si maskë e ngurtë. Prej disa ditësh shikonte të njëjtën ëndërr:

"Ja ku është nuse e re. Drurët e lakuriqtë të kopshtit e vështrojnë me ngulm, ajo turpërohet. I shoqi e përkëdhel me duar të avullta, rrekët ta puthë, nuk arrin asnjëherë, e zgjon trokitja e portës."

Hapi sytë e trembur. Iu desh një farë kohe të mblidhte veten.

"Nuk kam bërë asgjë të keqe, - kërkoi të shfajësohej përpara kushedi se kujt. - Përse?"

Kur u kthye Teli, shtëpia u mbush me jetën e tij, Tixhen, të ardhmen dhe papritmas ky çast ishte befasisht i përkryer. Qëndronte mes tyre, ndiente ngrohtësinë e shtëpisë. Kurora e qepëve të varura, tavolina e bukës, lulet e vaditura, fotot në mur, të gjitha ishin aty, e gëzonin pa masë. U kthjellua, mori pamje dinjitoze: shpatullat e shtendosura, kokën e lakuar pak përpara, sytë e butë të lagësht.

Përpiqej të përcillte një dëshirë.

Mezi gjeti frazën e duhur.

-Tetori është muaji i dasmave, ç'ta zgjatim? - tha me pamjen e njeriut që di shumë. Vetullat e ngritura i jepnin dinjitet.

-Mirë, - tha Teli.

Tixhja uli sytë e emocionuar.

-Ftojti miqtë e rinj, - foli si për diçka pa rëndësi.

Ktheu kokë nga dritarja, vështroi degët e zhveshura. Priste trokitjen në portë, po nuk e ndjeu. Me sytë e butë kadife vështroi përreth e qetësuar. Shiu reshti.

Hëna nxori mundimshëm veten përmes reve të çara, njomi me dritë të lagësht pemët e lakuriqta të kopshtit.

Tregim nga Bujar BALLIU

# Udha e shtëpisë

Sytë e gruas u çuditën si të kishin parë të pa parin. Ai e përshëndosh, hap krahët, e ngre hapa, e shtrëngon si ta bëjë pjesë të vetes dhe e lëshon në mes të dhomës së gjumit.

Shtratit të hapërdarë nuk i ve rëndësi. Më vonë do ta sillte nëpër mend si hollësi sfilitesë. Në mungesë të tij, ajo flinte në kuzhinë me fëmijët.

Lëvizjet e saj i ngajjnë të plogëta, të lodhura. Trupi topolak, dy gjiret e kërcyera, kofshët e bardha të padala kurrë në diell, dikur thërrisnin me gjithë gjuhët e noj-mave, i prishnin mendjen, tani shemben të lodhura. Sytë e kaltër fshihen nën qerpikët e rëndë.

"Kështu pritët burri i pa ardhur gjashtë muaj?"

Mëria lëvrin nën plisat e rrudhave, kërcen në tëmtha, mbetet fshehur vetullave të trasha. Murrëton vështrimin.

Nën guaskën e inatit, përgjon me sy tinëzëzë veprimet e së shoqes. Përreth syve të gruas nata e rimelit mbulon greminat e ditëve.

"Pse?" - Krimbthat e inatit mbulojnë zgërbonjen e nënkafkës.

-Do të dal.

-Kaq shpejt?-Uli kokën, rregulloi cepin e rrudhosur të fustanit.

-Do shkoj nga shkolla të marr fëmijët.

-Edhe unë bëj drekën rehat.

Sa herë kthehej, mezi i mbushte mendjen vetes se gruaja nuk shkonte me të tjerë. Ndoshta edhe pse vetë nuk duronte. Hera-herës vizitonte një vejanë greke.

"Gruas nuk i falet. Turpëron veten, fut burrin në dhe," - mbushte mendjen.

Udha e shtëpisë, mënjanoar nga të tjerat, spërkatet nga kurrizet e pashkelura të barishteve. Hedh sytë përçark. Shtëpia e vetmuar përfund kodrës, fshihet nga pemët e vjetruara e të pakrasitura prej vitesh. Kanatet e drunjët të dritareve mbyllur në të dy katet si gojë të vuvsura.

"Pse? Dimri nuk ka ardhur." -Dyshimi gjen tjetër rrugë. Te gardhi përfund arës iu faneps silueta e një burri që u përvodh hijeve dhe humbi në Përruan e Thellë.

"Po kjo?"

Turbullira u zbraz në gojë me shijen e baltës.

Rruga e faqes së kodrës e nxori në oborr të shkollës pas rreth një ore.

"Fëmijët sfiliten. Sidomos vajza. Sa ka plasur prej dherit."

Lindi me njëren këmbë më të shkurtër, por i vinte mirë që e bija ecte si gjithë moshatarët. E operuan në kohë. Para se të hynte në sallë, e vogla i nguli sytë e zez, e futi doçkën në pëllëmbën e të atit dhe thirri fort:

"Mos ma lësho dorën babi!"

Nuk mund të bënte asgjë. Futi kokën mes duarve. Kur u mbyll dera e akullt e sallës së operacionit, britma e hollë humbi në zgafellën e bardhë. Pas operacionit e gjeti të bijën shtrënguar mes peshash. Nga ajo kohë vështrimi i vajzës mbeti me kënd zemërate.

E nxehta e ditëve të fundit të shtatorit, e pazakontë këtyre anëve, i var mbi vetull një curril djerse. Në oborrin e shkollës era rrotullon pluhur e letra, ngre një re kafë, zapton sheshin e vogël, dritaret pa xhama, fëmijët e rrallë. Një thes bosh plastmase hidhet gardh më gardh si silueta e mashkullit vjedharak.

"Po zërin si mund ta ketë? Të hollë si fishkëllima e gjarprit barishteve? Të ngjirur nga të thirrurat nën zë? Kaba, të rëndë?"

Orari më i mirë: fëmijët në shkollë, shtëpia veç të tjerave, udhët pa njerëz."

Ajri u mbush me pluhur. Ndien në gojë shijen e dheut përzier me pëshëtimë. Luca kërcet dhëmbëve.

Mbarimin e mësimit e lajmëron tringëllima e një zileje dhish.

"Si në vegjelinë tonë!" - ndërmendet.

I hidhen në qafë fëmijët. Të birit, zgjatur si hije mëngjesi, fytyrimët, seriozitetin ia tradhton naiviteti i tipareve. Vajza i duket e vockël fare. Çanta e librave e ngjesh pas dheut. I shtrëngon në gjoks, i ndien eshtrave.

Qëndroi më gjunjë, i vështroi në sy. Diçka lëvriu në bebëzat e të birit.

"Dyshimi? Druajtja? Hija e rëndë e babait?"

Një re e zezë nxori çaponjtë krye Gjembthit.

"Më mirë ta zërë diellin. U bë vapë", -mendoi.

-Ikim! - u tha fëmijëve. Hyn në mes, i kap për duarsh, ndien mes gishtërinjve ajkën e lëkurës. Rrëshqiti përmes Përroit të Thellë. Fytyrës së çuditur të birit iu përgjigj:

-Bie shkurt. Në shtëpi dua të pyes për diçka?"

Vendosi atë çast. U çudit me arsytimin. Ende nuk e kishte të qartë bisedën e ardhshme me të birin.

"A mund të gjenden fjalë për një bisedë kaq të vështirë?"

Shohim e bëjmë. Ndoshta shtëpia m'i kullon mendimet."

Pas gjysmë ore, e shtëna e vetëtimës i shurdhlon, i tremb. Shiu fillon papritur. Rrebeshi oshtin grykës, fër-

shëllen krye pemëve, gulçet e erës të marrin frymën. Përroi i Thellë erret, buçet. Vija e hollë e ujit përdridhet gurëve si nepërkë e djegur për ujë.

-Shpejt!

Dy anët ngrihen thikë. Degët e holla gjysmë të zhveshura të lisave lëkunden e treten nëpër erë. Një dritë e ëndërrt merr spikamë të pruar nga gjethet. Ndriçojnë lajthishtat përkreu monopazit ku shtang një re e rëndë mal. Pas pak gjithçka nxihet, furtuna zbraz inatin purtekave të sapozhveshura. Shkrepat e hirtë varen bashkë me pikat e mëdha të shiut. Erdhi një çast kur rrebeshi i mbështjell me terr. Vragat e qullta presin ngastrat e ngrohta të lëkurës.

-Babi, m'u mbush këpuca! - ndihet për herë të parë zëri i ngashërës i së bijës.

Midis tyre llokoçitet ujë i errët. Këmbët i hedhin kuturu. Shtrëngon instinktivisht fëmijët në kyçet e imëta. Lëshoi të birin.

-Mbahu, të marr në qafë çupën!

Rrapëllima e përroit kërcet jo larg. Ulërima e ujit përmbi gurë, kanoset me hungëritje. Trupi i tij dridhet. "O zot, fëmijët!"

Uji u ngjit mbi kyçet e këmbëve. Rrjedha harbohet. Gjithnjë e më afër dëgjohet gurgullima e zemëruar. Përjashtësia ngjeth vetullën e harbuar, nguros qerpikun, thërmon nervin e tendosur të nofullës. Frika e së papriturës ngre kujën.

-Të vrapojmë! - bërtet të mbulojë poteren e përroit e makthin e brendshëm.

Pa mbaruar fjalën, uji kap gjunjët. Dredhëset e rrëkeve gërshetojnë putrat.

-Mbahu fort pas meje! - i foli pothuajse me pshëritimë të birit.

Humnera e lagësht hap gojën, përpin lëvizjet somnambule të rrënjëve lundruese. Ai, trungu i zi, krahëthyer, tërë xhunga hidhet mbi ujë, fshihet nën gardhin e degëve, nxjerr kryet frikshëm atje ku nuk e pret.

Shtrëngon fëmijët, merr frymë thellë, kërcen pas një guri të madh. Lëkura djeg nga kafshimet e ujit.

"Djali?!"

Tund dorën, e vështron. Ikonë e vogël, e lëmuar, e pastër, rrethuar me tufat e lagura të flokëve, ngjeshur nga klithma e pa shpallur. Hunda e bukur me majuc, gropëzat e faqeve ku çurgonin gjithë rrjedhat e fytyrës, u përpoqën të buzëqeshin.

-Babi të ka burrë! -Në boshin e lukthit avujt çurgojnë djersë të ftohta..

Gjithçka përçark humbet në kafën e errët të llucës. Monopetet shtrëngohen. Uji kap pjesët e sipërme, të ngrohta. Të tre vërtiten, ngjishen, hipin mbi gurë, rrëzohen sipas dëshirës së dallgës, tundin krahët si të dehur. Mes gishtave të tij dhe duarve të fëmijëve ka hyrë lëngu i trashë i llucës.

-Babi, mos më lësho! - e përmendi klithma e së bijës nga mbisupet.

"Mos e dhëntë zoti!"

Trembet nga guvat, tatëpjeta, copat e drurëve e gurëve. Shikon turbullirën ku mund të humbasë bashkë me fëmijët.

Vrapon, ndalet, picëron sytë. Shikimi le bebëzat, rend, kthehet i mjegullt, qëndron te guri çilak i pambulluar nga dallga. U lodh.

"Më mirë të rri këtu. Nuk dihet ku shkel. Po rashë mori fund gjithçka. Të pres? Kush më siguron se uji nuk ngrihet më lart? Jo, më mirë të ec. Sa kohë ka ikur? Nuk duhet të ketë mbetur shumë gjer te zalli. A do të arrij t'i dëboj me gjunjët e lodhur dhe vështrimin e tmerruar të fëmijëve valët kërcënuese?"

Në hapin e parë rrëshqet, përgjunjet. Fytyra e të birit u shtrembërua e mbeti si brunë i shtrydhur. Currili i hollë i zërit të vajzës ra në djerrinën e turbullt.

-Baaabiiiiii!

Dhe ai thërret. As vetë nuk dëgjon çfarë thotë.

Klithmat shuhen në ujin e paanë....

.... Pak yje të shastisur picërojnë sytë skajeve të qiellit.

Gojën e ka me batak. Qerpikët hapen nën lëngun e trashë të llucës. Ndihet i zhytur brenda kafkës. Larg, thellë, errët shquan trajtat e paqarta të vetes. Përcillet. Në fyt rrëshqet gllënja e llurbëtirës. Njohu yjet e shfytyruar, pyllin e heshtur, përruan, luginën, udhën, trupin e heshtur. Të dy krahët, shkrehur mbi zall, ngajjnë pa zot.

Dora kthehet, ngrihet, hapen gishtërinjët. Bie mbi gurë një copë dru i zhvoshtur. U drodh. Gulçi i baltës spërkat dallgën e qetuar.

Nuk e kupton: e hodhi në breg dallga e pistë dhe ai mbet pa shpirt, apo përroi u ngrit me rrapëllimë brenda tij, përmbity, shembi ç'desh, u derdh dhe atë e la të mpakur, të shterur?

Në gjoks ndizet vaji i korit të pazëshëm të zajeve të bardhë.

# Portret i traktoristit Llazar Ilia Kumbulla

**K**aloi një vit që u nda nga jeta, njeri prej traktoristëve të parë në zonën e Mokres, mjeshtri i madh i punës dhe mekanizatori i talentuar Llazar Ilia Kumbulla. I lindur në fshatin Pleshisht më 1942-n, në një familje me traditë të shquara pune. Brezat e meparshëm dhe sidomos babai i Llazit, Ilia dhe xhaxhai Zako Kumbulla, kishin ngritur një ekonomi nga me të mirat në fshatin Pleshisht, por dhe në zonë. Per ta zhvilluar dhe mirembajtur në vazhdim, këte ferme të vertete, me blegtori, gjedhe, kafshe pune e etj, detyruan Llazin si djalin me të madh të bëjë ndihmesë i të jatit që në moshe të njome, pas kryerjes së shkolles fillore. Kuptohet që u privua nga shume të drejta që ka kjo moshe dhe në menyre të vecante nuk mundi të realizonte endren kryesore, deshiren që ka cdo femije për të kryer një shkollë, si domosdoshmeri për tu bërë dikushi në jetë. Njeheresh, kjo periudhë pune u bë një përvjeje e përgjithshme, pasi fitoi shprehite e shumta të punëve bujqësore, blegtorale dhe artizanale, të domosdoshme e që i'u nevojiten gjithë jetën. Edhe me e rendesishme, ishte kultivimi dhe rrenjosja e vetive të larta psiqike, si vullneti i forte, kembengulja dhe ndjenja e sakrificës në punë, vetite morale, si drejtësia, mbajtja e fjalës, bujaria, mikepritja tradita këto mbare populllore, vecanerisht të spikatura në krahinën e Mokres, të cilat Llazi i reflektoi gjithë jetën e tij dhe në momentet me të veshitira të saj. Te gjithë ata që e kanë njohur nga afer, konfirmojnë këto cilësi të larta të tij, thone gjithashtu se ai tregonte bukur, rrefenjat dhe fjalët e urta, të mesuara që në vogeli, nga pletë me të ditur të Pleshishtit si, Simon Pjetri, Jovan Macolli, Llambi Pjetri, Llambi Kumbulla etj. Pikerisht, për këte, femijet kur ishin të vegjel, niperit mbesat e donin shume Llazin, tregojnë shume gjera të bukura, të mesuara nga ai, por edhe ankoheshin se e takonin rrallë atë. Puna e tij si traktorist e kerkonte që të punonte pa pushim, gjithë vitin, nuk gezonte të drejtën e pushimeve të të djelave, të festave të lejeve të zakonshme, madje në kohë fushatash punonin pa pushim 24 ore. Keshtu arriti të bëjë përgjegjes për hapjen e dhjetrave dynimeve të re në të gjithë krahinën. Në këto raste, edhe bukenja e dergonin në arë. Kthehej në shtëpi, tregon bashkeshortja e tij Krisanthi, vetëm për tu lare e nderruar. Sakrificat e tij ishin të panumerta, duke e zënë gjithë kohën vetëm me punë, nuk mund të bente kujdesin e domosdoshem as për shendetin e tij, por edhe për zgjidhjen e nevojave të shumta që kishte familja. Natyrisht, për punën e kryer shpërbleheshin me leke si gjithë të tjerët, por edhe paga e kishte një kufij në atë kohë, gjenin shume menyra për të mos na paguar aq sa na takonte, tregon Guri Spirollari, i cili bashkëpunoi për një kohë të gjatë me Llazin, deri sa u prish kolektivizimi. Me shume na shpërblenin me stimuj morale të ndryshëm, të cilat Llazi i kishte me shumice. E di, i them Gurit, ka një valixhe me flete nderi dhe lavderimi, ka tre dekorata, medalje dhe urdhëra pune, të dhena nga ish Kuvendi i Presidiumit Popullor. Di gjithashtu se, si punetori me i dalluar në rrethin e Pogradecit, e kishin deleguar disa here në kongresin e punetoreve të dalluar në Tiranë, në përvjetoret e festave të pavarësisë në Vlorë. Portreti i tij, i zmadhuar në picture, ishte vendosur për disa vite rresht në kendin e emulacionit pranë kinema Pojska. E permenda këte të fundit, sepse edhe në kur vinim nga qyteti i Fierit, po keshtu edhe femijet e mi që vinin për pushime verore, krenoheshin kur shikonin portretin e xhaxhait të tyre të dashur me parë se sa ta takonin atë vetë. Kishin të drejtë, nderhyn Guri, edhe unë krenohem dhe emocionohem si bashkëpunor i tij, sidomos tani që Llazin nuk e kemi më. Ti duhet ta dish gjithashtu, se Llazi është propozuar nga ndermarja e SMTse dhe nga Organizata e Bashkimit të Puntoreve të Rrethit, që ti jepej titulli i lartë i meritës 'Hero i Punes'. Ky nder me se i merituar nga Llazi për vite, nuk u bë sepse nuk e miratoi Organizata Baze e Partis nga gjukimi absurd



e i pabesueshem për kohën e sotshme, duke e quajtur Llazin përgjegjes se kunati i tij ishte denuar për shkelje kufiri, arsye që edhe në atë kohë ishte e pajustificuar, me ligj kunati nuk futej në rrethin e afërm të njerzve. Njeheresh ky gjukim, pati edhe pasoja të tjera morale të renda, duke mos i lejuar të gjithë femijet e Llazit të vazhdonin shkollën e lartë, apo të zinin ndonjë punë të merituar. Këto qëndrime ekstreme të të ashtuquajturëve "komuniste" me nivel shume të ulët kulturor dhe shoqëror, me shqipt të keq dhe egoizem të eger, ku të gjenin ndonjë gjë të vogël për të denuar njerzit padrejtësisht. Këto qëndrime dhe shume të tjera solen shkaterimin e gjithë sistemit të atëherëshëm, si c' dihen nga të gjithë tashmë. Duke vazhduar debatin, i kerkova Gurit të më tregonte ndonjë gjë të vecante, me dallues të punës që bente Llazi, në krahasim me të tjerët. Dihet se të gjithë traktoristët punonin shume. Guri, që e njihje mirë për disa vite Llazin, e ka të veshitire të tregojë për Llazin. Gjergji, degjo me tha, Llazi ishte një nga traktoristët e parë që u caktua për të punuar në këte krahinë. Në fillim shkollonte në të gjithë fshatrat ku e urdheronte SMTja, në Mokren e siperme dhe atë të poshtme. Në atë kohë tokat ishin punuar vetëm me krahe dhe kafshe pune, keshtu kuptohet që kishte shume veshitiresi, parcelat ishin të vogla, të ndara me mure guresh, me shkurre, me drure pemesh mes parceles, me gerryerje me hendeqe etj. Fillimi cdo punë gjithmone ka veshitiresi, por në këte rast ato ishin të shumta.

Traktorin e mori në dorezim vetëm pasi kishte punuar tre kater javë si ndihmes. Llazi ja dhane shpejtë deshmime e traktoristit, jo vetëm nga nevojja, por ai ishte treguar me i afti, që në provat e para. Para kesaj pune ai kishte fituar disa kategori, si mekanik. Meqenese kishte punuar si motorist, në minieren e Cervenakes, ku kishte kryer njeheresh vitet e fundit të shkolles 7 vjecare dhe një vit të mesme mekanike. Si c' theksuam, veshitiresite e bene të perdorte ruspen e traktorit qysh në fillim për të sistemuar token, para se ta plugonte. Duke treguar jo vetëm force, vullnet e kembengulje, por edhe zgjuarsia për të zgjedhur variantin me të mirë, fitoi aftesite e domosdoshme për të manovruar duke i rritur këto aftesi deri në mjeshtri të vertete. Njeheresh sforcimet që i beheshin motorit, për të shkuluar rrenje druresh, shkembenj etj, shkaktonte difekte të dukshme dhe të padukshme, të cilat duheshin riparuar. Pikerisht kjo ishte edhe puna me e veshitire për Llazin, sepse detyrohej të zberthente traktorin aty ku punonte, pastaj me veglat e demtuara në krah bente disa ore rrugë të lloshshme brenda dites, për të riparuar vete difektin sa me shpejtë. Kenaqesia që ndjente kur e rivinte në punë traktorin i jepte me shume besim, me shume force, e bente që të mos e ndjente lodhjen si c' thoshte, duke fituar njeheresh edhe aftesite si motorist e mekanizator. Kujdesej shume për ruajtjen dhe mirembajtjen e traktorit. Riparimet kapitale në oficinën qendrore i bente vetë. Në këte menyre, përfitonte kohën e punës me shume nga gjithë të tjerët. Pas mbarimit të punimeve për plugimin dhe mbjelljen e tokave, Llazi, fillonte punën për riparimin dhe hapjen e rrugëve. Sezoni dimrit ka qenë dhe është gjithmone i veshitire në krahinën e Mokres. Ishte shume i kerkuar nga ndermarja e ujesjellesit, për hapjen e kanaleve vaditese dhe ujembledheseve. Keshtu nuk njohu nderprerje të punës asnjehere. Kryesisht, këto shpjegojnë atë që në vitin 1985, Llazi beri buje në shkallë vendi kur në shtypin e asaj kohë u botuan artikuj e portrete si traktoristi që punonte për vitin 2008. Pra, 23 vite me shume nga plani i punës të regjistruar. E them këte, i sigurte se nuk raportohet e gjithë puna realisht, sepse Kooperativat Bujqësore, që ishin të varfëra duhej të paguanin shume SMTte, ndersa në na ngopinin me flete nderi e lavderimi. Po, i them,

nuk dyshoj fare që në atë kohë, puna e kryer paguhej vetëm me stimuj morale, por Llazi nuk i dhane as titullin Hero i Punes, të merituar disa here. Si për ironi, disa muaj përpara se semundja e rende dhe e pashërueshme ti merrte jetën, Llazi kishte punuar për hapjen e një rrugë në Dunice dhe nuk ishte paguar nga Komuna ende. Duket që ishte mesuar gjithë jetën me qëndrime të tilla, por nuk e dha asnjehere veten. Gjithsesi, i kerkoj Gurit të më tregojë ndonjë gjë me të vecante e karakteristike, për këte njeri me të vertete të madh, me virtyte të larta morale, me një vullnet të jashtëzakonshëm, një legjendar i punës nder vite. Kush e njih mi-re dhe ka pak dashamiresi, do të jete plotesisht dakort me këto vlersime. Ka aq shume histori për Llazin, tho-te Guri, aq sa mund të mbushin faqet e një libri, por do të vecoja dy raste që me kanë mbetur me shume në mendje. Punonim në një vend me pjerresi të madhe e të rrezikshme. Duke mos patur resurset e duhura, benim kursim duke e ndezur traktorin me leshim në tatepjetë. Në një moment traktorin mori shpejtësi dhe nuk mund të frenohet duke qenë me drejtim nga një gremine e thelle, në luginën midis Pleshishtit dhe Cezmes. Distanca ishte e shkurtër, nuk kishte kohë për të manovruar. Unë i alarmuar duke e ndjekur, i bertisja Llazit të hidhej nga kabina, të shpetonte veten. Ndersa ai shume i përqendruar manovroi në sekonda, duke i ndryshuar drejtimin traktorit mu në buze të gremines. Kur e kujtoj, edhe sot trembem. Do të theksoja edhe një rast të një pune të madhe, që beri Llazi, thjesht për ndihme shoqërore. Në një vend të veshitire kishte rreshkitur një makine Skode e drejtuar nga shoferi i njohur Vasil Macolli. Makina kishte ngecur disa metra poshte xhadese, e penguar nga fidanet e lisave dhe shkurret e shumta, për mos t'u rrokullisur me në thellesi, pa u demtuar aq shume. Kishin provuar për ta nxjerrë mjetet e parkut Pogradec, por nuk kishin mundur. Ndoshta shpenzimet e punës do të ishin me të medha se sa demi i shkaktuar, prandaj e braktisen makinën. Shoferi, për të cilin ishte një humbje e madhe, ju lut llazit ta shikonte njeherë, duke shpresuar pasi e njihje mirë zotesinë dhe aftesinë e punës se tij. Keshtu në një kohë relativisht të pershtatshme, duke lene disa pune që mund të prisnin, shkuan të vendi ku kishte rënë makina. Dukej me të vertete e pamundur. Gjithsesi Llazi nuk u terhoq, e shikon nga të gjitha anet dhe zgjodhi si variant për të hapur vendin nga poshte, me baze xhadene. Puna që duhet të benin ishte e veshitire dhe me kosto të madhe. Punuan disa dite deri sa vajten me traktor të makinës. Provan për ta terhequr por ishte e pamundur, makina mund të terhiqte drejt lumit edhe traktorin. Keshtu, për të shmangur rreshqitjen, e lidhen kamionin në disa pika, për ta mbajtur të koncentruar, pastaj me shume kujdes e terhinin me centimetra duke nderruar disa here lidhjet. Keshtu e zvarriten makinën deri në xhadë. Gjithë kjo punë, me të vertete e jashtëzakonshme, u shpërblje ashtu si c' nisi, me shprehjet e mahnitjes dhe habise! Si është e mundur vetëm me një traktor me peshe me të lehte se makina. Pra, në fund, na mbeten vetëm falenderimet e shoferit. Gjithsesi kur kujtojme këte veprim të guximshme, këto sakrificat të medha dhe shume të tjera, që reflektonte Llazi në punë dhe në jetë, na perforcohen mendimi dhe krenaria për këte njeri sa modest, aq dhe personalitet i shquar në punë dhe jetën shoqërore. Fatmiresisht, edhe sot ka njerez me horizont e kulture, ish drejtues të ndermarjeve ekonomike, që e kanë njohur mirë Llazin, e sot drejtojnë komuna e bashki. Njeheresh, dine mire se puna mbetet vlera me e shquar, me brilante në jetën e njerzve, nepermjet saj spikasit të vecantit që bëjnë histori, të vleresuar e të rivleresuar, duke lene menjane qëndrimet e perkohshme në rrjedhat e ndryshimeve politiko-shoqërore. Në këte kujtesë modeste, do të deshironim tu benim thirrje këtyre njerzve, që në kuadrin e kompetencave dhe mundesive të sotshme, të rivleresonin vlerat shoqërore të punës së Llazit, e cila i ben nder gjithë krahinës së Mokres dhe rrethit të Pogradecit.

Bledar KUMBULLA

## Minerali hekur-nikelit është futur në listën e së ardhmes

Nga Zabit CUKU

**T**endenca ka ndryshuar tani dhe vemendja është përqendruar tek materialet e ndërtimit, një nga këto është edhe ajo e hekur-nikelit në tërësi. Kështu është edhe zona e Librazhdit, Pogradecit, Korçës, Përrenjasit e tjera. Nëntoka e këtyre zonave janë shumë të pasura me hekur-nikel dhe kështu ky lloj minerali është futur në listën e së ardhmes. Nga studimet e specialisteve në vazhdimësi por edhe në kohët e fundit del se ka shumë rezerva. Sasia e ketij minerali ka qënë rreth 300 milion tonë, ndërkohë pas disa shfrytëzimeve të bëra aktualisht rezulton se mund të kenë mbetur edhe rreth 220 milion tonë

hekur nikel dhe rreth 110 milion tonë nikel silikat. Që të dy këta përbërës minerali janë të së njëjtës familje xeherorësh dhe kanë një përdorim të gjërë në industrinë e rëndë si një lëndë e parë për hekur dhe nikel. Zona e Përrenjasit, Katjelit, Mokres, Pishkashit, Shebenikut, janë shumë të pasura me shtresa dhe kanë rezerva minéralesh. Mundesia e shfrytëzimit të këtyre zonave ka një rëndësi të madhe sepse do të hapen shume vende pune në intreres të komunitetit të çdo zone duke rritur më tej mirqenjen e tyre. Qeveria po krijon mundësinë e krijimit të infrastrukturës për të thithur sa më shumë bizneset e kompanitë e huaja lidhur me shfrytëzimin e këtyre minéraleshve në dobi të komunitetit dhe ekonomisë në përgjithësi.

# Qëndresa e fisit Balliu në Slatinë e Senisht

Nga Zenun **FERO**

Fisi Balliu në Slatinë, dhe trangu në fshatin Senisht dhe Zalloret ishin banorë që banonin e punonin në këto male. S'kanë qënë as kaçakë, as hajdutë që t'i prisnin rrugën karvanit, por barinj me dhen e bujq. Nuk i binin njeriu në qafë, bënëin djathë e gjalpë, zbrisnin poshtë me caliket plot e i shisnin, me ato para, blinin kripë, sheqer, pëllhurë. Blinin plumb e barut për të vrarë ndonjë egërsirë a për të bërë zap ndonjë kundërshtar. Banonin në vende malore, hanin mish të pjekur në hell, hanin një oshmar të mbytur me gjalpë, apo mish me oshmar bashkë. (Mitrush Kuteli: Vepra letrare, Nr 1, Tiranë 1989, faqe 332)

Administrata turke u kërkonte "xhelepin", pagesën për gjënë e gjallë, dy grosh të bardhë për kokë pëlleja a shterpa, shelege e milor. Për të gjitha nga dy groshë. Ballinjët kishin kopera të mëdha se me ato ronin, Që të paguanin këtë xhelp, duhej të shisnin më shumë se gjysmën e gjësë gjallë, e të kishin shumë pak. Për këtë u ngritën bashkë me zalloret, dhe nuk i a dhanë xhelepin turkut.

Barinjët mbronin bagëtinë me dyfek në krah, dhe kanë luftuar kundër turqëve. Sipas shkrimeve të Mitrush Kutelit, Zalloret luftojnë me kapakllie, nizamët me dogra. Zalloret janë trima e njihnin vendin me pëllëmbë. Arrestojnë tre veta dhe i nisin por ata thyjnë pranget e këmbëve e të duarve, thyjnë hapsanën, marrin armët zaptijeve, i lidhin. Zien tërë Mokra, turqëve s'ua mbante të ngjiteshin maleve as me tre taborë. U'a kanë frikën Zallore. Këta nuk zbrisin poshtë, mbajnë kapën mbi sy e luftojnë. (Mitrush Kuteli, vepra letrare, Nr 1, Tiranë 1989, faqe 334-335)

Ballinjët kanë qënë të armatosur në shekullin e 19-të me pushkë "kapakllie", Berdan, pushkë me një fishek, e kalibrit 10.67 mm, e prodhimin rus. Ky emër iu dha nga që shuli hapej e mbyllej si kapak, si armatimi e kishte edhe ushtria turke. Është e modelit 1868-1870, me peshë 4.6 kg, e gjatë 134.3 cm. Gëzhojat e kësaj pushke mund të mbusheshin disa herë, edhe Ballinjët kishin pergatitur vetë kallëpët për përgatitjen e plumbave të fishekëve. Fisheku peshonte 54 gram, kompleti luftarak që mbanin ishin 60 fishekë. (Riza T. Drishti "Armët dhe armëtarët shqiptarë", Tiranë 1976, faqe 118) Ushtria turke në vitin 1871 u pajis me pushkë martina, dhe u lanë mënjanë pushkët e tjera. Edhe Ballinjët u armatosën me pushkë "martina" që kushtonte 5-6 lira flori. Kjo pushkë u prodhua edhe në

Elbasan, në vitin 1882-1883, dhe e quajën "huta shqiptare", e kalibrit 11.43mm, me katër vijaska peshë e plumbit 31.1 gram, shpejtësia fillestare plumbit 416m/sekond dhe peshë 4.1 kg. Në vitet 1897-1898 ushtria turke u pajis me pushkë "mauzer" e kalibrit 7.92mm, prodhim gjerman. Peshë 4.52kg, 4 vijaska, qitje me shenjestër 2000 metra, sasia e fishekve 5 copë, peshë e fishekut 23.75 gram, shpejtësia fillestare 895 m/sek.

Çmimi i pushkëve "martina" ra në tre mexhide të argjenda.

Pas daljes së pushkëve "mauzer" me zjarr të përsëritur, edhe Ballinjët blenë nga këto pushkë. Një mauzer belik (fabrikim gjerman) arriti të blihej 40 lira e barabarte me 880 franga ari.

Dëshira për të patur një mauzer, u shkatuan shumë dëme të mëdha edhe pushtuesëve turq, dhe vrisnin ushtarë turq për të marrë armët. Ushtarët turq nuk lëviznin në numër të vogël, por në numër të madh. Në çdo vend filluan të grabiteshin me forcë depot e ushtrisë turke. Më në fund erdhi një kohë që ata, të cilët ishin të armatosur (shqiptarët), ndërsa më parë i fshihnin armët nga frika e qeverisë, më vonë shëtisnin me armë nëpër tregje me pushkë në krahë, në mes të ushtrisë (turke) pa ia psur frikën. (Sulejman Sulçe "Shqipëria në historinë osmane", Izmir, viti 1944, faqe 381)

Në vitin 1903, në ushtrinë turke u fut pushka 7.65mm, me

peshë 4.52 kg, distanca e qitjes 2000 metra, me pesë fishekë, peshë e një fisheku 23.7 gram, me katër vijaska. Në vitin 1905 kjo pushkë u çmonte tepër dhe arriti të shitej deri në 4500 korona.

Në vitin 1907, një pushkë "martinë" origjinale shitej rreth 150 korona, dhe për 100 fishekë të kësaj arme paguheshin 30-32 korona.

Ballinjët banonin në male, me dyfeqe, e me pisqolle të arta, futur në silahe, me sy të ndezur. Ishin njerëz të gjallë, kishin shetëpi, gurin shtresë dhe qiellin mbulesë, gjithnjë në punë e luftra. Kishin pistoleta e "cube" ishin të vogla, mbaheshin edhe pas shpine, kur moshë dhe gjendja ekonomike nuk e lejonin të mbahej hapur. Nëpër dasma me këto armë organizoheshin

edhe gara qitje. Këto nuk mbaheshin si pistoleta nga dy copë në brez, por vetem nga një pistolet "cube" ishin të gjata 20-25 cm, ato me gjatësi mbi 25 cm nuk zbkuroheshin me argjend.

Pistoletat "tapanxha" punoheshin në Elbasan, me gjatësi 27 cm, stoliseshin me shije nga argjendarët, punime të ngrira në argjend. Këto kushtonin shtrenjtë, prandaj mbaheshin nga kryefamiljarët.


Pistoletat "teke" ishin të pazbukuruara, kalibri 12mm gjatësia 22 cm, largësia e plumbit arriti 20-25 metra, mbusheshin me një fishek. Me daljen e revolverve, pistoletat nuk përdorreshin më si më parë.

Revolveri "Gasser" model 1870 dhe 1898, kishin kalibër 11 e 12 mm, me sasinë e fishekëve 5-6 copë, peshë 1.35 kg, largësia e qitjes deri 50 metra.

Revolveri "Nagant" model 1895, kishin kalibrin 7.62mm me sasinë e fishekëve në mulli 7 copë, peshë pa fishekë 750 gram, me fishekë 834 gram, peshë e fishekut 11.87 gram deri 13 gram.

Rrobat i mbanin të regullta, me fustane kinda-kindra, me shtrësia të drejta si lisa. Ia merrnin valles herë shtruar, herë rrëmbyer dhe këndonin. Nxirrnin fyellin nga sihahu e i binin bukur, ëmbël, dhe këndonin përsëri. Në ato male shkrehnin pushkët, që thoshin: "Këtu jemi!"


Ishin të armatosur me armë në dorë, i tillë ishte vendi, për këtë shkak nuk mund të qëndrojnë i mbrojtur.



## Libri i Flori Slatinës "Dervish Bojka, arratisja drejt lirisë,, një vlerësim dhe realitet

Nga Sami **LEKA**

Kisha dëgjuar për arratisjen e Dervish BOJKËS, por pas leximit të librit vlerësova punën e mirë të autorit, me të dhenat e grumbulluara dhe të vërtetuara, sipas dokumentave arkivore dhe burimeve të tjera. Ky është një libër me vlera dhe përmasa të mëdha për krahinën e Mokrës. Aty del qartë diktatura që është ushtruar në atë zonë dhe në të gjithë vendin. Në këto shkrime del në pah varfëria që kishte pllakosur popullin e zonës së Mokrës. Nga kjo varfëria kanë marrë rrugën e arratisjes, këta të lodhur nga jeta, dhe si shumë të tjerë kanë qënë edhe Dervish Bojka, Bardho Leka, Sabri Çela e shumë të tjerë. Këta për një jetë më të mirë dhe jo për të përmbysur pushtetin, siç servirej nga sistemi i kaluar. Në këtë libër shikojme se autori ka qënë shumë i kujdesshëm në dokumentimin e të dhënave të marra. Ka hedhur dhe dokumentuar me fakte veprimtarinë e tyre të dhimshme, fisnike e burmore. Autorit i është dashur kohë dhe mbeshetjet për të nxjerrë realitetin e ngjarjes. Është dashur për të siguruar dokumentacionin dhe shfrytëzimin e të gjitha atyre dokumentave e fakteve të mbledhura në arkiv, por edhe me persona të tjerë, brenda dhe jashtë vendit që kishin mundësi për të hedhur



dritë për ngjarjet e kaluara. Me këtë rast vlerësoj Zotin Flori Slatina, për punën e bërë në një kohë disa vjeçare. Duke lexuar dhe e njohur me të dhënat e këtij libri, lexuesi dhe ai që e ka njohur do të heqë atë psikozën e keqe që ka ushtruar diktatura për diversantët në zonën e Mokrës. Pra në libër del e vërteta dhe realiteti. Tragjedia e vrasjes së Sabri Çelës në derën e shtëpisë në Velçan në vitin 1952 nga diktatura, sa tragjike, por edhe e dhimbshme për jetën e tij, për familjen, për nënën, e cila thotë: "Të vranë, o bir të vranë, sa unë nuk të pashë e s'të putha as të gjallë e as të vdekur, sepse të rrëmbyen sigurimisit si kur të ishe një kafshë e vrarë,.. Ende edhe sot familja, e të afërmit nuk e dinë varrin e tij. Në libër del në pah realiteti e origjina e familjes "Bojka". Dervish Bojka e donte familjen dhe siç shihet në libër ai skarifikon jetën për të dhe realizon atë që ai mendonte për familjen. Po ashtu del se ëndrra e Dervish Bojkës së bashku me shumë bashkëvujtës të tjerë që morën rrugën e arratisjes për liri u realizua në ditët e sotme të demokracisë, dhe doli realiteti i secilit. Brezat që janë tani, ata që kanë jetuar me të, por edhe ata që do të vijnë do të njohin dhe kujtojnë më respekt heroizmin e tyre legjendar. Në vazhdim presim mundësinë e promovimit të këtij libri edhe në zonën ku ka jetuar e banuar Dervish Bojka.

# Promovohet në Pogradec libri i Daut Kroit "Selca e Sipërme"

Më datën 26 nëntor, në 65-vjetorin e lindjes se tij, inxhinier Daut Kroi, promovoi në Pogradec librin "Selca e Sipërme, Mokër". Në takim u mbledhën mbi njëqind mokrarë, miq dhe të afërm të autorit. Në promovim ishte i pranishëm redaktori i librit, historiani Petrit Zeneli, kryetari i shoqatës së Vakëfllinjve z. Topçiu, kryetarët e Shoqatave Gora dhe Devolli për rrethin e Pogradecit zotërinjtë Eqerem Plloha dhe Festim Shpuza, banorë të fshatit Selcë e Sipërme etj.

Pas zotërinjve Topçiu dhe Zeneli për vlerat e librit folën kritikë Bardhi Hyka, shkrimtari

Bujar Balliu, Guri Ademaj etj. Emocione të veçanta solli vajza e autorit ardhur posaçërisht nga Italia dhe mbesat e tij me recitime të poezive që shoqërojnë librin.

Monografia voluminoze "Selca e Sipërme, Mokër" ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë jepet një tablo e zgjeruar e Mokrës në të gjitha planet gjeografik dhe etnografik me resurset e pafundme në bujqësi e blegtori, me historinë e lashtë e të vonë. Autori ka gërmuar me kujdes e përgjegjësi të lartë të dhëna me vlerë që nuk janë cekur asnjëherë në shkrimet për këtë Krahinë të lashtë. Vlerat etnografike dhe historike janë pa dyshim një gur i çmuar për të

gjithë studiuesit e ardhshëm.

Në pjesën e dytë ka realizuar hartën gjenealogjike të gjithë fiseve të fshatit me përpikmëri dhe një punë të gjithanshme kërkimore.

Janë pesë vite të gjata pune të palodhshme, të përditshme me një përkushtim shembullor e të admirueshëm.

Në fjalën e tij z. Daut Kroi foli i mallëngjyer me lot në sy për vendin e tij, fshatin dhe Krahinën të cilave u ka kushtuar këtë punim me vlera të lartë shkencore. Takimin e drejtoi z. Istref Haxhillari, n/kryetar i shoqatës "Mokra". Më poshtë po sjellim fjalën hyrëse të tij në këtë veprimtari të bukur.

## Përse largohen mokrarët?

Thonë se, kur njeriu kalon 50 vite dhe ka lënë prapa rininë e vrullshme e me ëndrra shumë, kthen kokën pas dhe kujton me mallëngjim kohën e shkuar, më shumë se kaq vendlindjen, ku çdo rrugë, gur apo përrua është i afërt e i dashur shumë. Varret e të parëve të bëhen të shtrenjta sa më s'ka, atje ku janë sot, në një varrezë të thjeshtë të thurur dosido nga dora e njerëzve.

Për gjithkënd vendlindja është e dashur, por unë them se për ne mokrarët ka shumë arsye të mburme e ta shpallim me të madhe se jemi bijtë e një krahine me shumë histori. Nuk ka asnjë grimë të historisë së kombit tonë ku Mokra të mos ketë qenë, në mos protagoniste, aktore me role të ndryshme sipas rastit.

Nëpër rrjedhat e kohës, Mokra dhe mokrarët, krenarë e të përfillur, punëtorë e të besës, të mençur e shakaxhinj, të gjendur në të mira e të këqija si rrallë të tjerë. Kush vajt e nuk mbeti mahnitur nga përthyerjet dhe bukuritë e pashoqe të vendit e natyrës, nga pritja e ngrohtë që zë fill të shpirti i njeriut, nga ajo dollia e hollë plot nur, e vjetër sa dheu mokrar?

Mbi këtë vend të bekuar dora e zotit ka shkundur hire natyrore pa kuruum.

Parë nga lart ngjason si qenie e gjallë stërmadhe, shpërfaqur si një çudi në këtë cep të dheut, me kokë mbështetur përmbi Kozic dhe trupin e hijshëm shtirë gjer tutje fushës së Përrenjasit. Shkumbini, gjaku i saj i pastër e përshkon të gjithën si enë e spërdredhur pambaruar kurrë.

Që kur, rrotull njëmijë vjet më parë, një perandor i huaj, habitur nga mullinjtë e shumtë (mokrat) përgjatë lumit, shqiptoi për herë të parë fjalën Mokër, vendi mban këtë emër të rëndë me shumë kuptim.

Ka qenë një kohë kur trojet tona mbanin me bukë një zonë shumë të gjerë. Drithi mbillej e korrej në fushë, po bluhej në male se aty ishin mullinjtë radhë - radhë e gjithfarësh, falë Shkumbinit ujëshumë dimër e verë. Dalëngadalë emri i krahinës u lidh ngushtë me bukën. Dhjetëra mullinj në Dunicë, Kalivaç, Trebinjë, Zëmçë, Slabinjë, Losnik e sa e sa fshatra të tjerë, bluanin pa pushim



grurë e misër, që vinte nga anë e anës. Gurët e mullinjve vërtiteshin hareshëm, zhurmonin dhe jepnin, pa u lodhur asnjëherë, bukën që mbante gjallë jetën e mijëra njerëzve të cilët udhëtonin ditë të tëra për të ardhur gjer këtu. Mullixhinjtë tanë, mjedhër të blojës, kishin zënë miqësi të shumta se banorët e hershëm të fushës së Korçës, ata përreth liqenit të Ohrit e shumë më tepër se kaq, u jepnin me dëshirë nuse djemve mokrarë.

A mos është e rastit që përplasia e madhe e Skënderbeut me pushuesit turq në përnisjen e saj u bë fushës së Përrenjasit dhe të parët luftëtarë ishin mokrarët?

A mund të gjejë njeriu, sado të përpigjet, ndonjë qoshe të historisë së trazuar të atdheut tonë ku mokrarët të mos kenë qenë rreshtuar në anën e zhvillimit të kombit, sado vetëmohim e mund të jetë dashur?

Sigurisht nuk mund të gjejë se kjo copëz e sertë e dheu të arbrit, nuk ndenji kurrë mënjatë përballë dallgëve të betejave në të gjitha kohët e shkuara. Mokra jonë ka qenë vërtet zonjë e rëndë.

Po tani?

E shpërfillur si kurrë më parë, lënë mënjatë pas dore e ka mbuluar pluhuri i harresës. Fshatra gjysmë të braktisura, lagje të tëra këthyer në murishte me ndonjë shtëpi të rrallë mbetur diku, pa u vënë re në një qoshe. Më së shumti të zë syri pleq që ecin gërmuqur rrugëve pa gjallëri dhe fëmijë. Të rinjtë dhe burrat në moshë rrahin dherat e huaja, veçan ato të Greqisë, vinë më të rrallë sjellin

ca thasë me miell dhe ikin përsëri. Të tjerë që nuk kanë mundur të çajnë jetojnë me shpresën se një ditë edhe ata do të ikin ashtu si të tjerët.

Ka edhe një pjesë që hahen me dheun, plugojnë me parmendën e stërllashtë ku, në vend të qeve, mbrehin kuaj e gomarë a thua se nuk jetojnë në shekullin e njëzetentjetë po diku në prehistori!

Ca të tjerë, që nuk janë të paktë, jetojnë vetëm me dru zjarr për ngrohje. Zhbëjnë pyjet e mbetura, rralluar shumë dhe i shesin. Presin ahet qindravjeçarë me keqardhje, po ç'të bëjnë tjetër për të nxjerrë bukën e gojës?

Migrimi bën kerdinë. Mot pas moti largohen dhjetëra familje ku të mundin e si të mundin po vetëm të ikin sikur i ndjek pas fati i lig, apo ndonjë kuçedër nga ato të qëmotit shpërfaqur prej nëndheut!

Ç'të jetë ky mallkim pa fund, i dhimbshëm përtej vetë dhimbjes? Përse mokrarët ikin dhe vetëm ikin...?

Poeti dhe mendimtari romak, Virgjili, para dymijë e ca vjetësh thoshte se perëndia u jep tokë, ujë dhe pyll, përmasa thelbësorë të jetës, vetëm njerëzve të mirë që nuk i shpërdorojnë po u falen si të shenjta.

Të tri këto përbërëse jetësore janë derdhur pa kursim mbi viset tona dhe mokrari nëpër shekuj i ka adhuruar si perëndi. A thua tani nuk i do më?

Kësaj pyetjeje rreket t'i përgjigjet z. Daut Kroi në librin e tij voluminoz "Selca e Sipërme, Mokër".

Korespondenti i gazetës "Mokra" në Pogradec.

## PORTRET-BIZNES/

# NJË LIN TURISTIK, ËNDRRA E TË ARDHMES PËR EMILJANO SHKIRËN

Emiljano Shkira sivjet e ka lënë emigracionin 10-vjeçar në Greqi dhe pas rikthimit në Lin, pranë Pogradecit ka hapur bar-restorantin "Turi", ku afron ushqime tipike të zonës.

"E kam fillimin, por e di që ka të ardhme turizmi familjar këtu në Lin", më thotë, ndërsa ngrohemi pranë zjarrit që kërcet në stofën e madhe mes sallës së lokalit të tij në qendër të fshatit buzë liqenit. Si për t'a mbështetur këtë ide, më tregon rrugën mospërmasë fshatit liqenor ku udhëtarë me makina që mbajnë targa qytetesh të ndryshme ecin drejt Mozaikut të Linit për t'a vizituar, pasi rruga e re e ndërtuar tre vjet më parë, tashmë e ka rritur numrin e vizitorëve aty.

Mbi restorant parashikon dhe dy kate sipër, ku do të ndërtojë 6 dhoma-garsoniera për pushuesit, por punimet ende nuk i ka mbaruar. "Do bëhen dorë pas dore", thotë me qetësi, ndërsa flet për nismën e tij për krijimin e garsonierave në disa prej banesave, që të ofrojnë turizëm familjar. "Me 6 kryefamiljarë që jetojnë në emigracion kemi rënë dakord që banesat e tyre këtu t'i përsh-tasin për turistët. I kanë nisur këtë vjeshtë rregullimet dhe punimet për të ndërtuar mjediset e brendshme dhe verën që vjen, këtu do të shtohen pushuesit. Do t'a menaxhoj vetë këtë punë", thotë Emiljano, ndërsa më tregon 6 banesat buzë liqenit. Sapo ka nisur një bashkëpunim tjetër me restorant "Malo" në Pojskë të Pogradecit për të punuar me agjencinë turistike "Fibulla" në Ohër të Maqedonisë për të sjellë turistë ditorë edhe në Lin. Se këtë verë ka pritur edhe vetë të huaj, kryesisht grupe të rinjsh çekë dhe holandezë, që udhëtojnë nëpër Shqipëri duke i akomoduar me çadrat e tyre alpine në katin e dytë ende të pambaruar. Tregon se ka bërë ciceronin për ta dhe i ka shoqëruar në malësitë e Polisit në Librazhd e përreth. "Ka qenë përvojë e mirë për mua se në ato zona malore kam njohur edhe blegtorë dhe po mendoj të marr prej tyre furnizimet e bulmetrave", thotë ai.

Nuk i rëndet të qëndrojë vetë para portës së lokalit buzë liqen-



it në fundjavë në këto ditë dimri që sapo ka mbërritur mirë, ku fton vizitorët turistë në restorant, pasi kanë përfunduar vizitën në Mozaikun e Linit.

"Tava me koran, belushkat dhe cironkat janë të freskëta se peshkatarët e fshatit na i sjellin përditë, por kemi dhe mish gici e keci, sipas stinës", tregon Emiljano menunë që ofron për klientët. Shpreson tek e ardhmja turistike e Linit, pasi gjykon se fshati po e largon emrin e keq të dikurshëm për papastërti.

"Banorët nuk mbajnë më bagëti pranë shtëpive", tregon ai, duke drejtuar gishtin lart, në mal, ku tashmë gjenden pak stane të vogla për to. Nuk për-ton aspak të pastrojë rrugën para lokalit çdo ditë, ndërsa gjykon se duhen ca nisma nga të rinjtë e fshatit. "Nuk para largohen djemtë këtu, se një pjesë punojnë në peshkim, por ka dhe shumë të tjerë që presin mundësi punësimit me turizmin familjar", më thotë disi i menduar.

Emiljano Shkira punoi 10 vjet në Athinë pranë një zyre avokatie si korrier dhe kriza greke e riktheu në vendlindje, ku po ngre të ardhmen. Megjithatë pranon se ka nevojë për konsulencë në fushën e turizmit familjar.

"Di që gjermanët kanë një zyrë në Korçë dhe kam menduar t'i ftoj këtu të shikojnë, ndoshta na ndihmojnë", thotë me besim.

Një organo dhe një kitarë aty, në cep të restorantit më tërheqin vëmendjen.

"Luan vajza ime mbrëmjeve", më flet për të bijën 13-vjeçare, që në Greqi i ka mësuar veglat muzikore.....

